



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

100 DITË

KTHESË DREJT ZHVILLIMIT

PRISHTINË, KORRIK 2021

100 DITË

KTHESË DREJT ZHVILLIMIT

PRISHTINË, KORRIK 2021

Hyrje

Ky raport paraqet punën e Qeverisë gjatë periudhës 23 mars – 1 korrik 2021, e cila është votuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 22 mars 2021.

Raporti fillon me fjalën e Kryeministrit të Kosovës, z. Albin Kurti, me rastin e mbledhjes së 18-të të Qeverisë. Më tutje, paraqiten të arriturat kryesore sipas sektorëve të paraparë me Programin e Qeverisë.¹

¹ Raporti është konsoliduar dhe si i tillë nuk përfshin të gjitha të arriturat gjatë kësaj periudhe kohore.

FJALA E KRYEMINISTRIT	8
I. MENAXHIMI I PANDEMISË COVID-19	10
Menaxhimi i pandemisë COVID-19	
Sigurimi i vaksinave, vaksinimi dhe shëndetësia	
II. RINGJALLJA EKONOMIKE	14
Pakoja e Ringjalljes Ekonomike	
Energjia dhe Minierat	
III. QEVERISJA	18
Reformat në financa publike dhe prokurim publik	
Planifikimi i integruar	
Agjenda e integritimit evropian	
Qeverisje efiçente	
Modernizimi i administratës publike	
Digjitalizimi për shërbime më të mira	
Ndërmarrje publike të qëndrueshme	
Qeverisja lokale	
Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve	
IV. SUNDIMI I LIGJIT	24
Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë	
Reforma në drejtësinë penale, civile dhe administrative	
Adresimi i krimeve të kryera gjatë luftës	
Përmirësimi i shërbimeve të profesioneve të lira ligjore	
Parandalimi dhe adresimi i dhunës në familje, ndaj grave dhe në baza gjinore	
V. RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	28
Parandalimi dhe luftimi i krimit	
Rritja dhe ruajtja e sigurisë publike	
VI. INDUSTRIJA, NDËRMARRËSIA DHE TREGTIA	30
Zhvillimi i politikave industriale dhe tregtare	
Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe inovacionit	
Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve të TIK	

VII. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL	34
Reformat gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale	
Rritja e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor	
VIII. MJEDISI, PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA	36
Menaxhimi i ujrave dhe ngritja e infrastrukturës	
Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit	
Infrastrukturë rrugore, hekurodhore dhe avicionit civil	
Siguria dhe mirëmbajtja rrugore	
IX. ARSIMI DHE SHKENCA	40
Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës	
Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës	
X. KULTURA, RINIA DHE SPORTI	44
Arti dhe kultura si kontribues qenësor në mirëqenien shoqërore	
Trashëgimia kulturore	
Sporti zhvillues i imazhit shtetëror	
XI. POLITIKA E JASHTME DHE DIASPORA	46
Reformimi i shërbimit të jashtëm	
Shtet ligjor demokratik me synim integrimin në BE dhe NATO	
Thellimi i bashkëpunimit me vendet me interes strategjik dhe marrëdhënieve dypalëshe	
Thellimi i bashkëpunimit me Shqipërinë	
Rritja e rolit të mërgatës në zhvillimin dhe promovimin e vendit	
Raporti me Serbinë	
XII. MBROJTJA	50
Zhvillimi i kapaciteteve për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial	
Përfshirja e FSK-së në ushtrimet ushtarake ndërkombëtare	
Fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile dhe rritja e llogaridhënies dhe transparencës	



6699

FJALA E KRYEMINISTRIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Të nderuar zëvendëskryeministra Besnik Bislimi dhe Emilija Rexhepi,

Të nderuar ministra e zëvendësministra të kabinetit qeveritar,

Të dashur qytetarë të Kosovës kudo që ndodheni,

Sot janë bërë 100 ditë të qeverisë që doli si rezultat nga zgjedhjet plebishitare të 14 shkurtit dhe unë jam i lumtur që të ndaj me ju progresin që kemi shënuar në këta 3 muaj, por edhe rrugëtimin e rëndësishëm që kemi filluar së bashku.

Në këto 100 ditë ne kemi marrë 144 vendime dhe kemi kaluar projektligje e dokumente të rëndësishme, të cilat kanë hedhur bazat për reforma afatgjata dhe themelet për shtet të drejtë e zhvillimor.

Kur e bëmë betimin në Kuvend më 22 mars ne thamë se prioritet kryesor është menaxhimi i pandemisë në mënyrë që të shpëtojmë jetë njerëzish të cilat po i humbim si pasojë e keqqeverisjes më shumë se sa nga pandemia. U zotua se do të bëjmë dy gjëra me urgjencë: së pari, do të sillnim një strategji me ndalë trendin në rritje të infektiveve të reja dhe ta kthenim mbrapshtë trendin e tmerrshëm të vdekjeve si pasojë e Covid-19 deri në eliminim të tij; dhe, së dyti, të sigurojmë vakcina sa më shpejtë e sa më shumë. Në ditën kur e pranua detyrën kishim 781 raste me infektive të reja me COVID-19 dhe 17 vdekje, kurse sot kemi 9 raste të reja dhe asnjë vdekje. Nuk gjetëm asnjë vaksinë, kur u rikthyem, dhe për më keq, asnjë kontratë të negociuar për sigurimin e tyre, ndërkaq sot kemi

2 milionë vakcina të siguruara, afër 400 mijë sosh kanë arritur dhe kemi mbi 200 mijë doza të administruara. Gjendja me pandeminë është vënë nën kontroll dhe situata është përmirësuar dukshëm. Në muajin mars deri në qershor kemi ulje prej 99% të rasteve të reja, 97% ulje të rasteve aktive dhe 86% ulje të rasteve të hospitalizuara.

Ky është sukses të cilit duhet t'i gëzohemi të gjithë sepse sot ndjehemi më të sigurt të takojmë njëri-tjetrin, të shijojmë ecjet dhe ajrin e pastër, me më pak frikë e me më shumë besim në institucionet tona që të bëjnë punën e duhur.

Natyrisht se sot, për shkak se situata me pandeminë është kaq e mirë, sukcesi mund të merret si diçka e garantuar që do të ndodhte vetvetiu, por nëse e kthejmë shikimin vetëm 100 ditë mbrapa e kuptojmë dallimin që nuk është më pak se kontrast dhe ndryshimin që është më shumë sesa përmirësim.

Andaj me kënaqësi raportojmë se pandemia në këto 100 ditë është menaxhuar me sukses, vaksinat janë siguruar dhe së bashku kemi përmbushur premtimin bazë ndaj qytetarëve.

Sot është evidente se ekonomia është hapur pothuajse në tërësinë e saj dhe qytetarëve i është kthyer një formë e normalitetit, duke lehtësuar kështu edhe peshën e rëndë që izolimi dhe distanca sociale kishin në shëndetin tonë mendor.

Por pandemia ende nuk ka mbaruar. Rreziku nga virusi mbetet i pranishëm dhe ne duhet të sillemi me përgjegjësi dhe kujdes, duke respektuar udhëzimet e institucioneve shëndetësore.

Pas pandemisë janë dy tema të cilat i kam përsëritur shpesh e për të cilat qytetarët na kanë votuar masivisht që ne të punojmë. E ato janë Drejtësi dhe Punë. Në këto 100 ditë, ekonomia jonë i është përgjigjur pozitivisht qeverisjes sonë të mirë dhe masave tona ndaj pandemisë.

Për periudhën e njëjtë, në krahasim me vitin e kaluar, eksportet janë rritur për 66%, aktiviteti ekonomik për 15%, të hyrat buxhetore për 30%. Në pesëmuajorin e parë të këtij viti, Dogana e Kosovës për herë të parë që nga themelimi i saj ka raportuar mbi 500 milionë euro të hyra për buxhetin e Kosovës, ndërkaq Administrata Tatimore e Kosovës ka raportuar se janë inkasuar rreth 60 milionë euro më shumë sesa në vitin e kaluar. Bazuar në këtë, Qeveria ka miratuar projektbuxhet për vitin 2021 prej 2.5 miliardë euro sipas së cilit projektohet rritje ekonomike për 7.9%, për dallim nga 5.2% siç parashihej në fillim të vitit, dhe në të cilin buxhetit do t'i shtohen 155 milionë euro më shumë nga çfarë planifikohej. Ky nivel parashihej të arrihej vetëm në vitin 2023.

Kjo rritje dhe ky ndryshim na jep shpresë se ditë më të mira po na presin. Natyrisht këto ndryshime pozitive janë rezultat i shumë faktorëve, por s'ka dyshim se rritja e besimit në institucione dhe punën e qeverisë, optimizmi dhe shpresa e qytetarëve për qeverinë e re dhe reformat që kemi filluar, formalizmi gradual i ekonomisë por edhe intervenimet tona në ekonomi përmes pakos financiare janë faktorët kryesorë.

I nderuar kabinet qeveritar,

U jam shumë falënderues dhe mirënjohës për punën që keni bërë në këto 100 ditë, për bashkëpunimin korrekt dhe aktiv që kemi pasur me njëri tjetrin, por ky është veçse fillimi. Vend për vetëmjaftueshmëri dhe relaksim nuk ka.

Nuk ka sepse qytetarët presin rezultate sa më shumë e sa më shpejtë. E ne e dimë se sa e vështirë është jeta për shumicën e qytetarëve të vendit tonë.

Qytetarët duan vende të reja të punës.

Prindërit duan të ardhura të sigurta për familjen që të mund t'i paguajnë faturat në fund të muajit, të sigurojnë ushqimin dhe gjërat elementare dhe të jenë në gjendje të kursejnë për të ardhmen.

Duan qasje në shëndetësi që funksionon dhe ku shërohen pa frikën e bankrotimit vetëm pse sëmuren.

Të rinjtë duan hapësirë për zhvillim, shkolla dhe universitete që i pajisin me dije që i hapin dyert e mundësisë në Kosovë e kudo në botë. Por edhe një garanci se ata mund të krijojnë familje dhe të ndërtojnë të ardhme këtu në vendin e tyre.

Pensionistët duan jetë të dinjitetshme, kujdes shëndetësor, parqe e ajër të pastër.

Kërkesat dhe pritjet e qytetarëve nuk kanë ndryshuar në këto 100 ditë, prandaj edhe themi se nuk ka vend për relaksim.

Zotimet tona ndaj qytetarëve dhe pritjet e tyre ndaj nesh duhet të bëhen udhërrëfyesi i punëve tona. Duhet t'u themi të vërtetën çdoherë e përherë, edhe kur punojmë mirë por edhe kur gabojmë, sepse ata na kanë zgjedhur t'u tregojmë jo çfarë duan të dëgjojnë, por çfarë duhet. Pra të vërtetën.

Andaj unë dua që suksesin tonë ta masim jo me sa mirë po qeverisim në krahasim me qeveritë e kaluara por se sa mirë po qeverisim në krahasim me pritjet e qytetarëve. Sepse, qytetarët janë ata vetë që nuk e bëjnë këtë krahasim. Ata e dinë se qeveritë e mëparshme nuk krahasohen me këtë qeverinë tonë që i ka ministrat e përgatitur e të ditur, të pakorruptuar e të përgjegjshëm.

Gara jonë është me të ardhmen jo me të kaluarën e këto janë 100 ditët e kthesës drejt zhvillimit.

Ju faleminderit.

Albin KURTI



Kryeministri i Republikës së Kosovës

I.

MENAXHIMI I PANDEMISË COVID-19

POPULLATË E
SHËNDETSHME

MENAXHIMI I PANDEMISË COVID-19

Qeveria e Kosovës gjatë 100 ditëve të para ka pasur **prioritet kryesor menaxhimin e pandemisë COVID-19** nëpërmjet masave të përshtatshme kundër COVID-19 dhe **sigurimin e vaksinave** për qytetarët e Kosovës.

Për shkak të numrit të lartë të rasteve dhe përkeqësimit të situatës epidemiologjike muajve pararendës, Qeveria e Kosovës, me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë e në bazë të rekomandimeve të ekspertëve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, mori masa kufizuese me qëllim parandalimin e përhapjes dhe futjen nën kontroll të pandemisë COVID-19. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha Inspektoratet dhe Policinë e Kosovës u fuqizua zbatimi dhe respektimi i tyre. Inspektorati Sanitar në bashkëpunim me autoritetet tjera ka realizuar 33, 700 inspektime.

Angazhimi i koordinuar i të gjithë mekanizmave në menaxhimin e pandemisë, zbatimi i masave me përpikëri, mbikëqyrja e zbatimit, dhe bashkëpunimi i qytetarëve ka ndikuar pozitivisht që situata epidemiologjike nga fillimi i muajit prill të përmirësohet dukshëm. Prandaj masat kundër pandemisë u përditësuan vazhdimisht duke i lehtësuar në përputhje me situatën epidemiologjike, dhe duke mundësuar rritjen e aktivitetit ekonomik në shërbim të tejkalimit të situatës emergjente dhe drejt ringjalljes ekonomike.

Veprimet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe përfshijnë:

- Vendimi për miratimin e masave të reja kundër COVID-19, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- Përditësimi i Udhëzuesve të përkohshëm të zbatimit të masave parandaluese të COVID-19 në sektorë të ndryshëm, me theks të veçantë në super shpërndarësit e identifikuar
- Hartimi i udhërrëfyesit dhe protokolleve për trajtim të pacientëve me COVID-19
- Krijimi i Grupit të ekspertëve për strategjinë e parandalimit, kontrollit dhe menaxhimit të COVID-19
- Revidimi i strategjisë për testimin me SARS-COV-2
- Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve mbikëqyrëse shtetërore për zbatim të masave të vëna nga Qeveria.




Fig. 1. Ilustrim i përmirësimit të situatës me pandeminë në periudhën mars-qershor

SIGURIMI I VAKSINAVE, VAKSINIMI DHE SHËNDETËSIA

Përkrah masave kundër COVID-19, Qeveria e Kosovës menjëherë pas marrjes së detyrës më 23 mars 2021 ka prioritetizuar përpjekjet për sigurimin e vaksinave si mjete më i avancuar në luftimin e pandemisë.

Angazhimi i Qeverisë së Kosovës për të arritur këtë synim ka qenë i orientuar në dy drejtime:

1) nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në kuadër të aleancës Covax

2) Ministrisë së Shëndetësisë, si udhëheqëse e negociatave në nivel të Qeverisë, për blerjen e vaksinave nga prodhuesit e aprovuar nga Agjencia Federale e Barnave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (FDA) dhe Agjencia Evropiane e Barnave (EMA).

Në javën e parë të marrjes së detyrës, Qeveria e Kosovës **filloi procesin e vaksinimit** sipas Planit Shtetëror për vaksinimin, falë 24 mijë dozave të para të vaksinës kundër COVID-19 të siguruar përmes aleancës COVAX.

Brenda 100 ditëve, Kosova ka pranuar mbi 160 mijë vakcina përmes aleancës COVAX, ndërsa ka siguruar mbi 95 mijë vakcina në kuadër të mbështetjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, 10 mijë doza tjera sipas marrëveshjes së nënshkruar me Republikën e Kroacisë dhe 180 mijë doza donacion nga Mbretëria e Norvegjisë.

Me qëllim mbrojtjen e profesionistëve shëndetësorë, të cilët që nga fillimi i pandemisë ishin në vijën e parë të frontit, sipas Planit Shtetëror, procesi i vaksinimit filloi pikërisht me ata. **Nga 29 mars e deri me 29 qershor janë vaksinuar mbi 12 mijë profesionistë shëndetësorë.**

Në fazën e parë të vaksinimit u përfshinë edhe personat e moshës mbi 80 vjeç, të moshuarit në shtëpitë e përkujdesjes dhe punonjësit socialë. Gjatë fazës së parë janë dhënë mbi 31 mijë vakcina.

Në javën e parë të muajit prill u funksionalizua Komisioni për Negocimin dhe Furnizimin me vakcinat kundër COVID-19, përgjegjës për sigurimin e vaksinave përmes kompanive prodhuese të tyre. Më 19 prill u miratua **Udhëzimi Administrativ** për autorizimin për marketing të produkteve medicinale, i cili i **hapi rrugë blerjes së vaksinave.**

NË DITËN E 66 TË QEVERISJES, u nënshkrua marrëveshja me kompaninë Pfizer për blerjen e 1,213,290 doza të vaksinave.

Kontingjentet e para me 188,270 vakcina të blera nga Pfizer arritën në fund të muajit qershor. Ky moment shënon hapin më të rëndësishëm për Republikën e Kosovës përballë pandemisë.

Në të njëjtën ditë, në mbledhjen e 14-të të Qeverisë, u miratua Plani i Veprimit për vaksinimin e qytetarëve në masë, në bazë të së cilit, sipas zotimit tonë, **më 15 qershor filloi VAKSINIMI MASIV i popullatës.** Ky plan synon administrimin e deri në 320 mijë vakcina brenda muajit, ashtu që t'i përgjigjet synimit tonë që brenda vitit të vaksinohen 60% të qytetarëve në grup moshën e atyre që duhet të vaksinohen. Për të realizuar këtë **janë rekrutuar 422 infermierë, 190 specializantë** dhe është ngritur numri i ekipeve të vaksinimit **nga 89 në 378.**

Gjithashtu, **janë rishpërndarë profesionistë shëndetësorë nëpër 30 qendrat e vaksinimit** dhe janë angazhuar kapacitete shtesë për administrim të teknologjisë informative dhe staf mbështetës. Janë siguruar edhe hapësira të reja për vaksinim të popullatës në çdo komunë.



Më tej, është bërë funksionalizimi i modulit të vaksinimit në kuadër të Sistemit të Informimit Shëndetësor dhe ka filluar informimi dhe vetëdijesimi i popullatës për rëndësinë e vaksinimit.

Aktualisht jemi në fazën e dytë të vaksinimit në të cilën tashmë kanë filluar të vaksinohen qytetarët mbi moshën 65 vjeç, personat me sëmundje kronike, mësimdhënësit, dhe forcat e sigurisë të përfshira drejtpërdrejt në menaxhimin e pandemisë.

Për të gjitha këto veprime, paraprakisht është bërë ndarja dhe alokimi buxhetor, duke siguruar blerjen e vaksinave dhe kryerjen e pagesave për këto vakcina në përputhje të plotë me marrëveshjen ndërmjet Qeverisë dhe Kompanisë.

Pas vlerësimit se vijueshmëria e furnizimit të rregullt me barna nga Lista esenciale është rrezikuar janë ndarë mjete financiare në vlerë prej **6.8 milionë euro për blerjen e barnave esenciale.**

“Qendra Operative Emergjente” e vaksinimit kundër COVID-19 është mbështetur në vazhdimësi edhe nga ekipe mjekësore nga FSK-ja.

Krahas aktiviteteve që kanë qenë të ndërlidhura me pandeminë, Ministria e Shëndetësisë ka krijuar grupet punuese për plotësimin dhe ndryshimin e pesë Ligjeve bazike të Shëndetësisë që mundësojnë riorganizimin e sektorit të shëndetësisë dhe reformimin e saj, e të cilat planifikohen të finalizohen deri në fund të vitit 2021.

Në 100-ditëshin e Qeverisë ka filluar edhe procesi i rrjetëzimit të profesionistëve shëndetësorë në mërgatë që për synim ka rritjen e cilësisë dhe shërbimeve shëndetësore përmes shkëmbimit të përvojave profesionale.

Në fushën e kontrolleve zyrtare në lidhje me sigurinë e shëndetit publik, janë realizuar gjithsej 17,004 kontrolle zyrtare, 14,838 prej tyre në produktet ushqimore dhe jo ushqimore me prejardhje shtazore dhe jo-shtazore, dhe 2,166 kontrolle zyrtare tjera janë kryer brenda vendit.

NË 100 DITË
janë siguruar mbi
2 milionë vakcina,
kanë arritur rreth
390 mijë dhe janë
vaksinuar 189,006
qytetarë.

II.

RINGJALLJA EKONOMIKE

EKONOMI E
ORIENTUAR DREJT
PRODIMIT DHE
EKSPORTIT

Ulja drastike e numrit të rasteve të reja ka mundësuar lehtësimin e masave dhe kështu puna e bizneseve të zhvillohet pa pengesa. Nënshkrimi i kontratës për blerjen e 1.2 milionë vaksinave ka kthyer optimizmin te qytetarët, të cilët kanë shtuar aktivitetin ekonomik, duke u ndjerë më të sigurt.

Ky aktivitet i shtuar ekonomik, bashkë me besimin në qeverinë e re, ka ndikuar që të kemi një performancë shumë më të mirë sesa që pritej në fillimvit për sa i përket të hyrave buxhetore.

Buxheti i rishikuar ka mundësuar dizajnimin e një pakoje të re që mundëson ringjalljen ekonomike të vendit dhe krijon bazë për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe të punësimit për vitet në vijim.

1.1 MILIARDË EURO

PAKOJA E RINGJALLJES EKONOMIKE

Pakaja e Ringjalljes Ekonomike përmban gjithsej investime prej 420 milionë euro të cilat priten të mobilizojnë edhe rreth 700 milionë euro tjera nga grantet, kapitali privat, dhe sektori financiar, për një shumë totale prej rreth **1.1 miliardë euro** kontribut në ekonomi.



Fig. 1. Pakoja e Ringjalljes Ekonomike

Ajo përmban një sërë masash dhe investimesh të cilat janë të përqendruara si vijon:

- **50 milionë euro** mbështetje për krijimin e **vendeve të reja të punës**,
- **108 milionë euro** mbështetje për ngritjen e **prodhimit vendor dhe rritjen e eksportit**,
- **112 milionë euro** për **shërbimet publike**,
- **50 milionë euro mbështetje për familjet**,
- **100 milionë euro** për **infrastrukturë** moderne dhe **mbrojtje të ambientit**.

Paraprakisht ishin ndarë 20 milionë euro mbështetje direkte për personelin shëndetësorë dhe policinë, bizneset e mbyllura dhe për të moshuarit dhe familjet me asistencë sociale.

— **5,255,565 euro** për sektorin e shëndetësisë dhe sigurisë.

- **4,010,907 euro** për sektorin e shëndetësisë në formë të shtesave **për muajin prill dhe maj** për **mjekët (150 euro)**, **infermierët (100 euro)** dhe **stafin mbështetës (100 euro)** të angazhuar në luftë kundër pandemisë COVID-19. Nga kjo masë kanë përfituar mbi 13,652 punëtorë shëndetësorë.
- **1,045,905 euro** për sektorin e sigurisë në formë të shtesave **për muajin prill dhe maj**, për **zyrtarët policorë (100 euro)** të angazhuar në terren dhe për rrezikun e ekspozimit ndaj virusit. Nga kjo masë kanë përfituar rreth 5 mijë punëtorë të sektorit të sigurisë.

— **6 milionë euro** për **bizneset** e ndikuara drejtpërdrejtë nga masat kundër pandemisë për subvencionimin deri në 50% të pagës së punëtorëve dhe pagesës së qirasë.

- **2,907,886 euro** për subvencionimin e pagës së **23,153 punëtorëve**.
- **801,773 euro** për subvencionimin e **1,673 biznese** për qira.

Si mbështetje shtesë për bizneset, afati për pagesën e tatimeve për periudhën tatimore 2020, deklarimi i pasqyrave financiare, afati i pagesës dhe deklarimit vjetor për tatimin në të ardhurat personale dhe tatimin në të ardhura të korporatave është zgjatuar deri më 30 prill 2021. Po ashtu, është shtyrë afati për deklarimin vjetor për ortakëritë dhe deklarimin e pasqyrave financiare përmes sistemit EDI.

— Rreth **8.5 milionë euro për përfituesit e skemave sociale dhe pensionale** për pagesën e shtesës prej 30% mbi shumën mujore për përfituesit nga skema e ndihmës sociale dhe për pagesën shtesë për përfituesit e skemave pensionale që marrin më pak se 100 euro në muaj, për muajt prill, maj dhe qershor 2021. Nga kjo masë kanë **përfituar 192,171 qytetarë**.

Po ashtu, ka filluar ekzekutimi i pagesave për obligimet ndaj fermerëve në vlerë prej 8.9 milionë euro.

Mërgata jonë është pjesë integrale e planit tonë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Brenda 100 ditëve është marrë vendimi për emetimin e letrave me vlerë, “Bono të Diasporës”



Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati në takim me ambasadorin e BE-së në Kosovë, Tomáš Szunyog.

Nëpërmjet tyre, do t'u mundësohet bashkatdhetarëve tanë që kursimet dhe kapitalin e tyre ta orientojnë në investime zhvillimore që do të krijojnë vende të reja të punës. Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me palët e përfshira do të përcaktojë specifikat teknike të emetimit të këtyre bonove.

Me rikthimin e aktivitetit ekonomik, do të rikthehet edhe kërkesa për punëtorë të cilët ishin liruar nga puna shkak i ndikimit negativ të pandemisë në ekonominë e vendit. Në këtë drejtim, vëmendje të veçantë do të kenë të rinjtë të cilët hyjnë në tregun e punës për herë të parë. Në përputhje me këtë synim dhe me Programin e Qeverisë **është themeluar grupi punues për dizajnimin dhe operacionalizimin e skemës për punësimin e garantuar të të rinjve**. Skema ka për qëllim punësimin e të rinjve të moshës 18-24 vjeçare dhe paga e atyre që punësohen, përmes kësaj skeme, për herë të parë do të subvencionohet nga Qeveria.

Përpos tyre, ka filluar procesi i studimit të fizibilitetit për sistemet e ngrohjes qendrore në nivel të komunave të Kosovës dhe janë bërë përgatitjet për fillimin e trajnimit dhe certifikimit të grupit të dytë të auditorëve të energjisë në Kosovë.

ENERGJIA DHE MINIERAT

Qeveria është angazhuar që gjatë kësaj periudhe të trajtojë me prioritet sektorin e energjisë dhe minierave. Bazuar në objektivat shtetërore dhe në Programin e Qeverisë, ka filluar puna me hartimin e politikave kryesore me qëllim të përfundimit të dokumenteve strategjike dhe atyre planifikuese. **Ministria e Ekonomisë gjatë këtyre 100 ditëve ka hartuar dokumente të cilat përfshijnë:**

- Koncept dokumentin për Burime të Ripërtëritshme të Energjisë
- Planin e Veprimit të Agjendës për Reforma Evropiane II për sektorin e energjisë dhe ndërmarrjeve publike
- Draft dokumentin e Profilin të Energjisë së Kosovës
- Draft Planin e Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës për vitin 2021
- Draft Programin e Zbatimit të Strategjisë Minerare 2021-2023.

III.

QEVERISJA

100 DITË
18 MBLEDHJE
144 VENDIME
19 PROJEKTLIGJE
4 KONCEPT-DOKUMENTE



Kabineti Qeveritar i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti: z. Besnik Bislimi, znj. Donika Gërvalla, znj. Emilija Rexhepi, z. Hekuran Murati, znj. Albulena Haxhiu, z. Arben Vitia, znj. Arbërie Nagavci, z. Hajrulla Çeku, z. Elbert Krasniqi, z. Liburn Aliu, z. Faton Peci, z. Armend Mehaj, z. Xhelal Sveçla, znj. Rozeta Hajdari, znj. Artane Rizvanolli, z. Goran Rakiq dhe z. Fikrim Damka.

Qeverisja e mirë dhe demokratike dhe reformat e nisura në drejtësi, financa publike dhe ekonomi kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të institucioneve publike bashkë me besimin dhe bashkëpunimin e qytetarëve me to. Për periudhën e njejtë, në krahasim me vitin e kaluar, **eksportet janë rritur për 66%, aktiviteti ekonomik për 15%, të hyrat buxhetore për 30%**. Në pesë mujorin e parë të këtij viti, **Dogana e Kosovës për herë të parë** që nga themelimi i saj ka raportuar **mbi 500 milionë euro** të hyra për buxhetin e Kosovës, kurse **Administrata Tatimore e Kosovës ka raportuar se janë inkasuar rreth 60 milionë euro më shumë** në krahasim me vitin e kaluar.

Bazuar në këtë, Qeveria ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2021 prej **2.5 miliardë euro** sipas së cilit projektohet **rritje ekonomike për 7.9%** në terma nominal për dallim nga 5.2% siç parashihej në fillim të vitit dhe në të cilin buxhetit do t'i shtohen 155 milionë euro më shumë nga çka planifikohej. Ky nivel parashihej të arrihej tek në vitin 2023.

Dy prioritetet kryesore të buxhetit për vitin 2021 vazhdojnë të mbeten mbulimi i nevojave emergjente në luftimin dhe parandalimin e pandemisë dhe ringjallja ekonomike.

Në këto 100 ditë e parë është punuar intensivisht për vendosjen e bazës ligjore për reformat zhvillimore që synojmë gjatë mandatit tonë dhe adresimin e problemeve strukturore në qeverisje dhe institucione tjera publike.

HEQJA E HOMOLOGIMIT

Sipas zotimeve, Qeveria ka miratuar propozimin për largimin e homologimit për veturat që importohen nga BE, Zvicra dhe Norvegjia, duke liruar qytetarët nga një barrë e panevojshme dhe për t'i dhënë fund kështu monopolit 12 vjeçar në homologimin e automjeteve.

RUAJTJA E PARASË PUBLIKE

Që nga fillimi i mandatit ka filluar një operacion për identifikimin e parregullsive dhe keqpërdorimeve me qëllim të vënies së rendit dhe ruajtjes së parasë publike.

PËR 100 DITË JANË ANULUAR marrëveshje të dëmshme - tenderë dhe memorandume - me vlerë prej 100 MILIONË EURO

— **44 milionë euro** nga tenderi për mirëmbajtje të rrugëve, sipas të cilit lejohej ngritja e vlerës deri në 30%, pra 57 milionë euro. Me rishpalljen e tenderit janë kursyer 22 milionë euro (MMPHI).

— **33.5 milionë euro** nga memorandume pa mbulesë buxhetore (MMPHI).

— **21 milionë euro** nga tenderi për furnizimin me dokumente blanko personale, avancim të sistemeve dhe mirëmbajtjes së tyre (MPB).

— **1.5 milionë euro** nga anulimi i thirrjes nga progami komunal për zhvillim të infrastrukturës dhe bashkëpunim ndër-komunal për shkak se kriteret kanë qenë të pabarabarta, të padrejta dhe të paqarta (MAPL).

— **Mbi 1 milion euro** nga dy tenderë (MFPT).

— Është ndërprerë një kontratë e vitit 2019 me vlerë mujore prej **13,535 euro** për një objekt i cili nuk ishte shfrytëzuar asnjëherë (MFPT).

— **1 milion euro** të ngrira nën dyshimin se kanë të bëjnë me shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit (MFPT).

— **160 mijë euro** të rikthyera në buxhet, pas identifikimit të pagesave të dyfishta dhe të parregullta (MFPT).

Më tej, gjatë kësaj periudhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) **ka filluar pastrimin e listave të përfituesve të skemave pensionale të cilët kanë përfituar nga më shumë se një pension.**

TRANSPARENCA FINANCIARE

MFPT ka rritë transparencën sa i përket financave publike. Është publikuar lista e 50 përfituesve më të mëdhenj nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike të vitit të kaluar të qeverisë së kaluar dhe 50 përfituesit më të mëdhenj të Pakos Fiskale Emergjente të Qeverisë Kurti I. Në maj është bërë publikimi i pasqyrave financiare për tremujorin e katërt për ndërmarrjet publike.

Si rezultat i këtyre veprimeve, të cilat parashiheshin si kritere për marrëveshjen financiare ndërkombëtare për ndihmën makro-financiare nga BE-ja, është mundësuar disbursimi i 50 milionë euro, të cilat do të përdoren si mbështetje buxhetore për mbulimin e shpenzimeve në ringjalljen ekonomike. Ky është disbursimi i dytë nga marrëveshja në fjalë e cila kap shumën e 100 milionë eurove.

Transparenca rritë integritetin e institucioneve. Ministria e Drejtësisë, për herë të parë ka ofruar **qasje në shpenzimet** e bëra për mbështetje financiare **në mbrojtjen e të akuzuarve pranë Dhomave të Specializuara**, kurse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka filluar publikimin në baza javore të shpenzimeve të kabinetit dhe në baza mujore ato të ministrisë.

PLANIFIKIMI I INTEGRUAR

Qeveria e Kosovës është zotuar që të përcaktojë prioritetet afatgjata për zhvillimin e vendit përmes Strategjisë Kombëtare për Zhvillim.

Prandaj, ka filluar vlerësimi i saj, përmes së cilës do të prezantohen rekomandime për prioritetet zhvillimore, në veçanti për zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Janë finalizuar analizat për të gjithë sektorët e politikave publike (SWOT), që do të shërbejnë për definimin e prioritetëve zhvillimore.

Kosova është përfshirë në procesin e Specializimit të Mençur, si pjesë e procesit të Berlinit. Në kuadër të kësaj, vendet e rajonit, të mbështetura nga Komisioni Evropian, do të hartojnë Strategji për Specializim të Mençur si një qasje inovative që ka për qëllim të zhvillojë përparësitë krahasuese të vendeve.

AGJENDA E INTEGRIMIT EVROPIAN

Në lidhje me agjendën e integrimit evropian, puna dhe planifikimi është fokusuar në prioritetet politike dhe Programin për Zbatimin e MSA-së.

Në funksion të koordinimit ndërmjet institucioneve brenda vendit për zbatimin e reformave për integrim në BE, janë konsoliduar strukturat koordinuese vendore në të gjitha nivelet përmes vendimit për themelimin e Strukturave Koordinuese Ndërinstitucionale për Procesin e Integrimit Evropian.

Qeveria ka miratuar projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, nga ku siguron **mbi 100 milionë euro investime** në formë të granteve dhe huave.

Qeveria po ashtu ka miratuar grantin investues nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor (WBIF) për autostradën Besi-Merdarë, në vlerë prej **38 milionë euro**, dhe është ratifikuar marrëveshja financiare për bashkëpunim ndërkufitar për IPA 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, e cila siguron qasjen e zonave kufitare në fonde me vlerë prej mbi 1 milionë euro.

Gjithashtu, janë rinegociuar treguesit e përkrahjes buxhetore sektoriale për reformën e administratës publike për vitin 2021, përmbushja e të cilëve do të sigurojë përfitimin e fondeve IPA në shumë prej **5.5 milionë euro** dhe është kryer kërkesa për realizimin e disbursimit të përkrahjes buxhetore në kuadër të IPA 2019.

Sa u përket prioriteteve politike, gjatë kësaj periudhe janë finalizuar prioritetet e fazës së dytë të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA II) dhe Plani i Veprimit për zbatimin e tyre (PV ERA II), së bashku me institucionet relevante vendore dhe në konsultim me Komisionin Evropian (KE). Përveç kësaj, PV ERA II është diskutuar dhe miratuar në parim në nivelin më të lartë politik, në mbledhjen e parë të Këshillit Ministror për Integrim Evropian, të mbajtur më 21 maj 2021.

Në anën tjetër, rishikimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) është në përmbyllje e sipër në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për zbatim.

QEVERISJE EFIÇIENTE

Qeverisje efiçiente do të thotë rregullim më i mirë që përmirëson mënyrën e punës dhe funksionimit të Qeverisë. Ajo e zvogëlon barrën administrative për bizneset dhe qytetarët duke eliminuar burokracitë e tepërta dhe është e hapur para qytetarëve, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile.

Andaj, në këto 100 ditë, në kuadër të agjendës për Rregullim më të Mirë dhe me qëllim të reduktimit të barrës administrative për lehtësimin e qasjes së qytetarëve në shërbime publike janë bërë përgatitjet për analizën e rreth 2500 akteve ligjore.

Gjithashtu, është punuar në përmirësimin e komunikimit dhe konsultimit të politikave me qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile përmes avancimit të shërbimeve digjitale që ofrohen në kuadër të Platformës së Konsultimeve me Publikun, duke shtuar funksionalitete të reja dhe rritjes së transparencës në lidhje me shpenzimet e Qeverisë për sektorin e shoqërisë civile përmes Platformës së Financimeve Publike.

MODERNIZIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Prej prioriteteve kyçe të Qeverisë është reforma dhe modernizimi i administratës publike. Pas marrjes së detyrës, si veprim i parë, është përditësuar përbërja e Këshillit Ministror për Reformën e Administratës Publike (KMRAP), përgjegjës për të siguruar, koordinuar, monitoruar dhe zbatuar dokumentet strategjike të reformës së administratës publike. KMRAP ka mbajtur takimin e parë në të cilin, ndër tjera, janë shqyrtuar dhe aprovuar raportet mbi zbatimin e kornizës strategjike për reformë të administratës publike.

Në shërbim të të njëjtit prioritet, Qeveria e Kosovës ka aprovuar planin një vjeçar tranzicional të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike. Miratimi i tij i ka hapur rrugë hartimit dhe miratimit të kornizës së re strategjike.

Gjatë kësaj periudhe, po ashtu janë ndërmarrë hapat e parë, përkatësisht themeluar ekipet punuese, drejt kompletimit të kornizës ligjore të reformës së administratës publike në harmoni me rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese.

Ligji për Zyrtarët Publikë do të rregullojë në mënyrë uniforme marrëdhënien e punës në administratën publike midis shtetit dhe zyrtarëve publikë mbi bazën e meritës, integritetit dhe paanësisë, kurse **Ligji për Paga** do të rregullojë përfundimisht sistemin e pagave të zyrtarëve publikë sipas parimit **“punë e njëjtë, pagë e njëjtë”**.

Racionalizimi i Agjencive dhe organeve të pavarura do të bëhet.

Qeveria tashmë ka kryer fazën e konsultimeve paraprake për projektligjin për Valën e parë të Racionalizimit dhe Vendosi e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura.

Ndërsa, ka filluar hartimi i projektligjit për inspektimin administrativ me qëllim rritjen e llogaridhënies në administratë publike, parandalimin e fenomeneve të keqpërdorimeve në realizimin e proceseve dhe procedurave administrative dhe aplikimin e masave ndëshkimore me gjoba në rast të mosperformimit sipas obligimeve që dalin nga detyra zyrtare.

NDËRMARRJE PUBLIKE TË QËNDRUESHME

Qeveria ka ndërmarrë vendime për **shtatë borde të ndërmarrjeve publike**.

Nën monitorimin e partnerit zbatues të Ambasadës së Britanisë së Madhe dhe BIRN është emëruar Bordi i Ndërmarrjes Publike të Telekomit të Kosovës.

Në anën tjetër janë emëruar **bordet e përkohshme në gjashtë** ndërmarrje publike:

- Trepça Sh.A
- Korporata Energjetike e Kosovës/KEK Sh.A
- Posta e Kosovës Sh.A
- Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës INRAKOS Sh.A.
- KRU Prishtina
- HIDROEKONOMIA "Ibër Lepenci"

Kurse deri më tani **janë shpallur pesë konkurse publike**, tre për ndërmarrje publike, një për Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM):

- Trepça Sh.A
- Posta e Kosovës Sh.A
- KRU Hidromorava Sh.A, Gjilan
- Për kryetar dhe dy (2) anëtarë të OSHP
- Për pesë (5) anëtarë të KPM

QEVERISJA LOKALE

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka iniciuar reformën e kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale. Kështu, ka filluar plotësim ndryshimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe i 7 akteve tjera nënligjore.

Më tej, është hartuar Koncept Dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Grantit të Bazuar në Performancë. Ky koncept dokument synon të krijojë qëndrueshmëri të sistemit dhe Grantit për Performancë komunale.

Ndërkohë është përmblyllur procesi i përzgjedhjes së komunave përfituese nga Granti për Performancë

komunale për komunitet të cilat gjatë vitit 2019 kanë treguar performancë më të lartë në ofrimin e shërbimeve. **Për 21 komuna**, janë ndarë 4.35 milion euro, prej tyre 1.5 milionë euro nga buxheti i MAPL-së për financim të 25 projekteve në 8 komuna.

Me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë dhe promovimit të të drejtave të komunitetit jo shumicë në Komunën e Graçanicës, pas katër vjetëve refuzim të kundërligjshëm, me insistimin e MAPL-së kanë filluar procedurat për emërimin e nënkryetarit nga radhët e komunitetit shqiptar në këtë komunë.

Pas një periudhë të gjatë të mosfunksionimit të Komitetit të Auditimit, në mungesë të një anëtari nga shoqëria civile, ky Komitet është funksionalizuar brenda 100 ditëve.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE

Qeveria dhe institucionet e linjës kanë zhvilluar aktivitetet të ndryshme me qëllim të respektimit të të drejtave të të gjitha komuniteteve si dhe kthimit dhe integritetit të personave të zhvendosur nga territori i Kosovës. Disa nga to përfshijnë:

- 2 shtëpi të ndërtuara dhe 8 tjera në ndërtim, përmes fondeve të Ministrisë, mbështetjes së BE-së përmes projektit dhe projekteve të përbashkëta me partnerë tjerë ndërkombëtarë.
- 10 pako të harmonizuara familjare dhe 68 fonde stimuluuese (grante) në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura.
- Materiale ndërtimore për 10 familje. Përfituesit e kësaj janë familjet në nevojë në të gjithë Kosovën.

Nga "Programi i BE-së për Stabilizimin e Komuniteteve – Faza e Tretë", janë mbështetur 41 projekte individuale për fillimin e biznesit të vogël dhe 7 projekte infrastrukture për komunitetet.

IV.

SUNDIMI I LIGJIT

DREJTËSI E
PAVARUR, E
PAANSHME DHE
PROFESIONALE

SUNDIMI I LIGJIT

Për të rikthyer besimin qytetar, Qeveria e Kosovës gjatë këtyre 100 ditëve është angazhuar në reformimin e sistemit të drejtësisë dhe në kompletimin e kornizës ligjore të nevojshme për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe zbardhjen dhe dënimin e krimeve të luftës.

Qeveria ka marrë hapat e parë në **përbushjen e zotimeve për procesin e vettingut, konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, adresimin e krimeve të luftës dhe krijimin e Gjykatës Komerciale.**

PËRMIRËSIMI I INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË

Në mënyrë që sistemi gjyqësor dhe prokurorial të veprojë drejt dhe të jetë i barabartë ndaj të gjithë qytetarëve, është e domosdoshme që në të gjitha nivelet e këtyre sistemeve të ketë njerëz profesional dhe me integritet.

Ministria e Drejtësisë i ka dhënë vëmendje urgjente reformës në drejtësi përmes procesit të vettingut.

Në muajin e parë të detyrës, ka filluar hartimi e Koncept Dokumentit për procesin e Vettingut

REFORMA NË DREJTËSINË PENALE, CIVILE DHE ADMINISTRATIVE

Një prej koncept dokumenteve të para të miratuara nga Qeveria, që në mbledhjen e gjashtë, ishte Koncept Dokumenti për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme. Pas miratimit të tij,



Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu duke proceduar në Qeveri koncept dokumenin për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.

menjëherë është formuar Grupi Punues për hartimin e projektligjit për konfiskimin e pasurisë së pajustificuar. Ky projektligj është tejet i rëndësishëm për luftimin e kriminalitetit dhe vendosjen e drejtësisë.

Miratohet Koncept Dokumenti për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme

Pas tij është miratuar edhe Projektligji për Agjencinë për parandalimin e Korrupsionit, i cili do ta reformojë Agjencinë Kundër Korrupsionit duke e veshur me kompetenca dhe përgjegjësi që ndihmojnë zbatimin e drejtë të Ligjit për Konfiskimin e pasurisë së Pajustificueshme me bazë civile.

Në rrafshin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, Qeveria ka miratuar Projektligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për Çështje Civile. Përmes tij, Gjykatat e Kosovës do të komunikojnë drejtpërdrejtë me ato ndërkombëtare.

Sa i përket reformës në drejtësi administrative,

U MIRATUA PROJEKTLIGJI PËR GJYKATËN KOMERCIALE

që mundëson themelimin dhe funksionalizimin e Gjykatës. Ajo do t'i hapë rrugë investimeve të bashkatdhetarëve tanë dhe investimeve të huaja në vend.

Gjithashtu, është aprovuar Rregullorja për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, e cila është qenësore në raportimin dhe luftimin e korrupsionit.

Në kuadër të rishikimit funksional në sektorin e sundimit të ligjit, është arritur pajtueshmëria për shkëmbimin e të dhënave statistikore ndërmjet gjyqësorit, prokurorisë dhe Ministrisë së Drejtësisë përmes sistemit elektronik për menaxhimin e lëndëve (SMIL). Kjo fuqizon politikat dhe planifikimin strategjik afatgjatë dhe rritë llogaridhënien dhe efikasitetin brenda sistemit të drejtësisë.

ADRESIMI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS

Në fushën e drejtësisë tranzicionale është themeluar dhe funksionalizuar grupi punues për **themelimin e Institutit për adresimin e krimeve të luftës** të kryera në Kosovë, dhe është miratuar plotësim ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale që mundëson gjykimin në mungesë.

Në këtë kontekst, Departamentit për Krime Luftë në kuadër të Prokurorisë Speciale, nga ky vit i janë shtuar **4 prokurorë specialë, 6 bashkëpunëtorë profesionalë, 2 përkthyes.**

Në shërbim të kësaj është hapur thirrja publike për pranimin e dokumenteve dhe dëshmimeve të tjera për krimet e kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Çështja e personave të zhdukur ka vazhduar të trajtohet si çështje me prioritet të veçantë. Gjatë kësaj periudhe kohore, familjeve të personave të zhdukur iu janë dorëzuar për rivarrim mbetjet mortore të shtatë personave të identifikuar dhe një rast është në kuadër të konfirmimit të identitetit.

Me prioritet është trajtuar lokacioni i varrezës masive në Kizhevak, Rashkë (Serbi). Gjatë gjurmimeve dhe zhvarrimeve në këtë lokacion, sipas të dhënave të ekspertëve mjekoligjor janë gjetur dhe zhvarrosur mbetjet mortore të të paktën 10 personave, viktimat e luftës.

Në këtë tremujor në zbatim edhe të Planit të Punës të Komisionit për adresimin e çështjes së mbetjeve mortore të pidentifikuara dhe me përkrahjen e Ambasadës Zvicerane dhe Britanike në një angazhim të përbashkët me Sektorin e Policisë për Hetimin e Krimeve të Luftës, **ka filluar faza e parë e digjitalizimit të dosjeve të personave të zhdukur.**

PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE TË PROFESIONEVE TË LIRA LIGJORE

Në përkrahje të fuqizimit të rolit të profesioneve të lira, **janë ulur për 50% tarifat e kompensimeve për kryetarët dhe anëtarët e komisioneve.**

Në të njëjtën kohë, është funksionalizuar Komisioni për Provimin e Jurisprudencës dhe është ulur **nga 100 euro në 50 euro pagesa për paraqitjen e provimit të jurisprudencës** duke e bërë atë më të qasshëm për juristët e rinj.

Mbështetje e rëndësishme i është ofruar edhe Avokaturës Shtetërore në rastet e arbitrazhit ndërkombëtar, ku Republika e Kosovës është palë e paditur. Kështu, kanë përfunduar procedurat për angazhimin e firmës ligjore për përfaqësim të Kosovës në arbitrazh në tri rastet e fundit dhe kanë përfunduar koordinimet e nevojshme për rekrutimin e ekspertëve.

PARANDALIMI DHE ADRESIMI I DHUNËS NË FAMILJE, NDAJ GRAVE DHE NË BAZA GJINORE

Pas emërimit të Koordinatorës Nacionale për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, për herë të parë është funksionalizuar grupi ndër ministror për adresimin e çështjeve të dhunës në familje.

Po ashtu, është krijuar Grupi Punues për hartimin e strategjisë për adresimin e çështjeve të dhunës në familje dhe janë bërë analizat e para në kuptim të adresimit të çështjeve të dala nga Konventa e Stambollit dhe të krijimit të linjave buxhetore për strehimoret, për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje.

	Nga	Në
Zgjedhjen e Noterëve	15€	6€
Provimin e Noterisë	10€	6€
Provimin për Përmbarues Privat	13€	6€
Administrator Falimentues	13€	6€
Jurisprudencë	10€	6€

Fig. 3. Ulja e tarifave të kompensimit për kryetarë dhe anëtarë të komisioneve.

V.

**RENDI DHE
SIGURIA
PUBLIKE**

SIGURI PËR TË
GJITHË QYTETARËT

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT

Republika e Kosovës vazhdon të përballet me një mori rreziqesh, kërcënimesh dhe sfidash në fushën e rendit dhe sigurisë publike. Qeveria mbetet e përkushtuar t'i adresojë me prioritet të lartë ato.

Në bashkëpunim të suksesshëm me autoritetet e Italisë, DEA-së Amerikane dhe Shqipërisë, është realizuar një nga operacionet më të mëdha.

400KG KOKAINË TË KONFISKUAR

Policia e Kosovës ka përmbyllur me sukses operacionin ndaj dy grupeve kriminale të përfshira në veprën penale "Pjesëmarrja ose Organizimi i Grupit Kriminal të Organizuar" që lidhen me kontrabandë me migrantë dhe falsifikim i dokumenteve.



Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Svecła vizitë Doganave dhe Aeroportit të Kosovës

Në lidhje me mashtrimet e qytetarëve gjerman nga call-center në Kosovë janë realizuar 21 kontrolle nga Policia e Kosovës ku janë sekuestruar 2,387,621 milionë euro, 9 vetura dhe janë arrestuar 18 persona.

Gjithashtu, janë sekuestruar rreth 18 mijë pako me rreth 400 lloje të ndryshme të barnave dhe është ngritur aktakuzë ndaj 13 personave zyrtarë (nga të cilët 9 të doganës), nën dyshimin për kontrabandim të rreth 80,000 mijë kilogram duhan, me dëm potencial ndaj buxhetit të shtetit prej mbi 3 milionë euro.

NË 100 DITË

101 operacione
221 bastisje
933 të arrestuar
8 grupe kriminale të shkatërruara
7 milionë euro të konfiskuara

RRITJA DHE RUAJTJA E SIGURISË PUBLIKE

Meqenëse siguria kibernetike është një problem në zgjerim e sipër, jemi angazhuar në ngritje të kapaciteteve profesionale për parandalimin e sulmeve kibernetike, kompletimin e kornizës ligjore dhe modernizimin e pajisjeve për mbrojtje kibernetike.

Rrjedhimisht, ka filluar instalimi i pajisjeve për Autentifikim dy faktorësh (two factor authentication) dhe enkriptim të shënimeve në disk. Qëllimi i këtyre pajisjeve është ngritja e sigurisë për qasje në kompjuter dhe siguria e të dhënave. Gjithashtu **është finalizuar Projektligji për Siguri Kibernetike.**

Kurse në kuadër të forcimit të integritetit të institucioneve të rendit dhe sigurisë, nga muaji qershor **Inspektorati Policor i Kosovës është anëtar i plotë në Shoqatën Kombëtare të Hetuesve të Punëve të Brendshme - NAIA të SHBA-së.**

VI.

**INDUSTRIA,
NDËRMARRËSIA
DHE TREGTIA**

NDËRMARRJE
KONKURRUESE

ZHVILLIMI I POLITIKAVE INDUSTRIALE DHE TREGTARE

Ky sektor ka pasur mungesë të trashëguar të politikave që hapin rrugë dhe mundësojnë zhvillimin e fushave dhe nënfushave të tij, andaj vëmendje e veçantë gjatë 100 ditëve i është kushtuar hartimit të kornizës bazë ligjore.

Në këtë funksion, janë miratuar në Qeveri:

- Koncept dokumenti për Fushën e Pronësisë Industriale,
- Projektligji për Tregti të Jashtme
- Projektligji për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme.

Ndërsa janë në procedurë të miratimit ose finalizimit edhe shumë të tjera duke përfshirë këtu:

- Projektligjin për Konkurrencën,
- Projektligjin për Metalet e Çmuara,
- Projektligjin për Inspektimet,
- Projektligjin për Turizëm,
- Projektligjin për Markat Tregtare,
- Projektligjin për Sekretin Tregtar.

Kontrolli i naftës kthehet në Doganë.

Një vendim shumë i rëndësishëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ishte ai i anulimit të pjesshëm të Udhëzimit Administrativ për kontrollin dhe cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.

Kontrolli tani bëhet nga Dogana e Kosovës, e cila ka kapacitetet më të lartë për një kontroll të tillë, e jo kompanitë private që përfitonin falë lidhjeve të tyre me qeveritë e kaluara. **Me këtë vendim, është kthyer ligjshmëria dhe janë mbrojtur kontributet e tatim paguesve.**

Në kuadër të përmirësimit të mjedisit të të bërit biznes u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit në mes Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve dhe Administratës Tatimore të Kosovës për qasjen dhe shkëmbimin e informatave në mënyrë elektronike. Kjo nënkupton lehtësimin e punës së ATK-së në hetimin e veprave penale në fushën e tatimeve, e cila njëkohësisht rritë transparencën.

Ndërsa në bashkëpunim me Ambasadën Gjermane në Kosovë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka bërë lansimin e përditësimit të platformës EDI të ATK-së. Ky përditësim mundëson lehtësimin e kryerjes së obligimeve nga bizneset.

ZHVILLIMI I NDËRMARRËSISË DHE INOVACIONIT

Ka vazhduar monitorimi i fazës së parë dhe të dytë të bizneseve përfituese nga "Iniciativa për Fuqizim Digjital", projekt ky i financuar nga Qeveria dhe ADA Austriake. Përfitues të këtyre dy fazave janë 52 biznese vendore, nga programet për fuqizim digjital si Marketing Digjital, E-Commerce, Programe Softuerike dhe aktivitete të ngjashme. Qeveria është duke mbështetur Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në plasimin e produkteve në panaiet ndërkombëtare sikurse ai në ANUGA 2021 në Gjermani, në PLMA 2021 "World of Private Label" në Holandë dhe ENOEXPO në Dubai.

Gjatë periudhës raportuese është bërë finalizimi i raportit për implementimin e skemës, "Përkrahja direkte financiare për projektet inovative të bizneseve fillestare Start-Up". Kurse sa i përket legjislacionit është bërë **finalizimi i draft rregullores për funksionalizimin e Qendrës Rajonale për Inovacion dhe Ndërmarrësi në hapësirat e Laboratorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike**, dhe finalizimi i Udhëzimit Administrativ për Grantet e Inovacionit.

Ndërsa është finalizuar zbatimi i projektit “Krijimi i Qendrës për Ekselencë Digjitale” në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren. Aty janë instaluar katër Printer 3D industrial, një Skaner 3D dhe dy softuerë përkatës. Gjithashtu janë duke u realizuar edhe trajnimet për përdorimin e këtyre pajisjeve.

Kurse në kuadër të programit “after care” (kujdesi i më pastajmë ndaj investitorëve) janë vizituar **3 investitorë të cilëve u është ofruar përkrahja e mëtutjeshme.**

ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS DHE KAPACITETEVE TË TIK-UT

Në fushën e telekomunikacionit dhe teknologjisë informative e komunikuese, Qeveria ka miratuar Projektligjin për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besueshme për Transaksionet Elektronike dhe Projektligjin për Masat për Uljen e Kostos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë. Në këtë drejtim, projekti i Shtrirjes së Infrastrukturës brezgjere në zona të pambuluara përmes programit



Kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari në ceremoninë e pritjes së bizneseve të para në Parkun të Biznesit në Prizren.

KODE është realizuar me sukses. Janë nënshkruar edhe 8 marrëveshje të reja për lidhjen me infrastrukturë fikse brezgjere të tetë përgjive tjera të rrjetit mobil, zbatimi i të cilave do të përfundohet deri në tetor 2021. **Lidhja e këtyre përgjive mundëson ofrimin e shërbimit cilësor të rrjetit 4G në zonat më rurale** e që njëherësh këto pajisje aktive përkrahin edhe rrjetin 5G (5G Ready).

Po ashtu, është marrë vendimi që projekti për Krijimin e Stacionit Nacional për Monitorimin e Spektrit të frekuencave (SNMS) të trajtohet si projekt me qëllim të mbrojtjes nacionale. SNMS do t'i mundësojë **Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), bordi profesional i së cilit është emëruar në fund të muajit maj**, të fuqizohet në aspekt të rregullimit të tregut, respektivisht për monitorimin e shfrytëzimit të spektrit frekuencor.

Falë bashkëpunimit të Ministrisë së Ekonomisë me Këshillin Rajonal të Bashkëpunimit (RCC) dhe aprovimit të rregullores të ARKEP, **nga 1 korriku nuk do të ketë tarifa të roamingut për Ballkanin Perëndimor**. Kjo do të thotë që telefonatat dhe përdorimi i internetit nuk do të ketë kosto shtesë.

Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren, i cili ishte hapur gjatë Qeverisë Kurti 1, në këto 100 ditë mirëpriti gjashtë bizneset e para nga sektorë të ndryshëm që tashmë kanë filluar punën në hapësirat e reja.

VII.

**BUJQËSIA DHE
ZHVILLIMI
RURAL**

BUJQËSI
ZHVILLIMORE

REFORMAT GJITHËPËRFSHIRËSE INSTITUCIONALE DHE SEKTORIALE

Fokusi gjatë kësaj periudhe ka qenë avancimi i legjislacionit, dhe reformimi i tij për të eliminuar keqmenaxhimin dhe keqpërdorimin e deritashëm. Rrjedhimisht janë formuar **ekipe punuese për pesë projektligje** të rëndësishme për veprimtarinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ka filluar puna rreth hartimit të dy strategjive afatgjata.

- Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027
- Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2021-2030.

Gjithashtu, janë marrë **32 vendime** për lejimin e importimit, vendosjen në treg dhe përdorimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve.

Me qëllim të zvogëlimit të licencave, heqjes së taksave dhe zvogëlimit të barrës për bizneset janë miratuar udhëzime administrative të cilat **zgjasin afatet e licencave:**

- Nga 1 në 5 vjet për importin, eksportin e verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera
- Nga 1 në 5 vjet për regjistrimin e kultivuesve të rrushit, prodhuesve të verërave, verërave frutore dhe prodhimeve tjera nga rrushi e vera
- Nga 1 në 3 vjet për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për vlerën kultivuese prodhuese dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave
- Nga 1 në 3 vjet për regjistrimin, licencimin dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor.

RITJIA E KONKURENCËS NË SEKTORIN AGRO-USHQIMOR

Pas skanimit të gjendjes së përgjithshme janë identifikuar **30 milionë euro** borxh shkaku i obligimeve të krijuara nga Programi i Rregullt dhe Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike për Pagesa Direkte/Subvencione.

Ky borxh paraqet vështirësi në zbatimin e mëtutjeshëm të politikave dhe programit për bujqësi dhe zhvillim rural. Prandaj, është themeluar Task Forca për shqyrtimin dhe verifikimin e lëndëve të cilat janë në procedurë të realizimit të pagesave. **Me këtë veprim deri tani janë kursyer rreth gjysmë milion euro.**

Megjithatë, nga fillimi i mandatit e deri tani

janë ekzekutuar

4,579,543 euro

subvencione dhe grante për fermerët dhe bujqit

dhe janë ndarë edhe

8,962,899 euro

për kompensimet e subvencioneve të dyta.

Në kuadër të vendimeve të ndërmarra me qëllimin e parandalimit të keqpërdorimit me Projektet e Zhvillimit Rural/Grante, është pezulluar vlerësimi i aplikacioneve të thirrjes së dytë në mënyrë që procesi të jetë sa më transparent dhe ligjor dhe është paraqitur kërkesa për Auditim të Brendshëm tek Projektet e Zhvillimit Rural/Granteve.



VIII.

**MJEDISI,
PLANIFIKIMI
HAPËSINOR DHE
INFRASTRUKTURA**

ZHVILLIM I QËNDRUESHËM
NË HARMONI ME
MJEDISIN E PASTËR DHE
MOBILITETIN

MENAXHIMI I UJRAVE DHE NGRITJA E INFRASTRUKTURËS

Menaxhimi efektiv i resurseve ujore është parakusht për sigurimin e ujit në sasi të mjaftueshme, në cilësinë, vendin dhe kohën e duhur për nevojat e popullatës dhe të zhvillimit ekonomik.

Për herë të parë, është iniciuar hartimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore për lumenjtë Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenc si dhe është konceptuar një program master mbi Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore.

Gjithashtu **për herë të parë**, me synim për të ngritur transparencën dhe qasjen e publikut, ka filluar inventarizimi i procedurave për fitimin e së drejtës ujore dhe krijimi i një sistemi të menaxhimit të të dhënave për leje (i ashtuquajtur "permit tracking system") dhe ndërlidhja e tij me sistemin informativ ujqor.

PEZULLOHEN APLIKIMET PËR HIDROCENTRALE

Është themeluar grupi punues ministror, i përkrahur nga shoqëria civile dhe ekspertë të jashtëm, për shqyrtimin e akteve administrative të lëshuara për operatorët e hidrocentraleve dhe për të evidentuar ndikimin e tyre në resurse ujore, mjedis dhe në bilancet ekonomike të komunitetit.

Me qëllim të mbrojtjes dhe menaxhimit të resurseve ujore janë krijuar edhe dy grupe tjera ministrore: grupi ministror për shqyrtimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit, rregullave financiare, kontratave, memorandumeve të bashkëfinancimit të projekteve nga fusha e resurseve ujore dhe për verifikimin në terren të projekteve të zbatuara dhe grupi ministror për shqyrtimin e pagesave të shfrytëzimit dhe shkarkimit të ujërave, finalizimin e databazës së të dhënave për obligimet e operatorëve ekonomikë.

Kurse sa i përket ujërave të zeza, tashmë ka nisur hartimi i konceptit nacional për menaxhimin e llumit, i domosdoshëm për menaxhimin e qëndrueshëm të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.

MBROJTJA E NATYRËS DHE BIODIVERSITETIT

Për t'i dalë në mbrojtje mjedisit, pas evidentimit të gurëthyesve dhe akteve administrative me të cilat janë pajisur është marrë vendimi për vendosjen e moratoriumit për gurëthyesit e rinj dhe ato në procedurë për pëlqim mjedisor për periudhën dy vjeçare.



Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe zëvendësministrja e MPHI, Linda Çavderbasha vizitë në Shtërpçë, Brecovizë dhe Biti në Ditën Ndërkombëtare të Tokës.

MORATORIUM DY VJEÇAR PËR GURËTHYESIT E RINJ

Baza e të Dhënave Hapësinore për Planifikim Hapësinor është funksionalizuar plotësisht në nivel kombëtar dhe komunal, duke e përfshirë edhe përditësimin dhe aktivizimin e Platformës SPAK—Aplikacioni për Planifikim Hapësinor për Kosovë.

Në fushën e **banimit social** tashmë është arritur marrëveshja për fillimin e studimit të fizibilitetit **për banim të përbalueshëm dhe social**, në bashkëpunim me UN-Habitat.

INFRASTRUKTURA RRUGORE, HEKURUDHORE DHE E AVIACIONIT CIVIL

Qeveria është angazhuar në vazhdimin e realizimit të projekteve të infrastrukturës rrugore ku vetëm gjatë kësaj periudhe

u zhbllokuan 20 KONTRATA PËR 20 PROJEKTE

të cilat nuk kishin zhvilluar aktivitet përmbi 2 vjet.
Po vazhdojnë punimet në rrugën Prishtinë–Mitrovicë, Prishtinë–Podujevë , Zhur–Dragash–Brod.

Në bashkëpunim me WBIF-in, EBRD dhe EIB-në ka përfunduar hartimi i Projektit Preliminar për **segmentin e Autostradës Besi – Merdare** për të cilin qeveria ka miratuar grantin investues në vlerë prej 38 milionë euro.

Pas takimit me Ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut **është bërë studimi i fizibilitetit për Rrugën Prizren–Tetovë.** Në mbledhjen e ardhshme mes dy Qeverive pritet të nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e kësaj rruge.



Në sektorin e hekurudhave në bashkëpunim me ekspertët e BERZH-it dhe WBIF është bërë hartimi i projektit të parastudimit të fizibilitetit për Linjën Hekurudhore Prishtinë–Aeroport.

Pas më shumë se një vjet, kanë rifilluar punimet për zgjatjen e pistës së aterimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Punimet do të përfundojnë gjatë këtij viti. Ky projekt ka rëndësi të veçantë për shkak të pajisjeve moderne të cilat vendosen e që mundësojnë aterimin e aeroplanëve edhe në kushte të vështira atmosferike. Gjithashtu me këtë projekt do të ketë shkurtime të rrugëve ajrore e që si rezultat do të ketë uljen e çmimeve të biletave.

SIGURIA DHE MIRËBAJTJA RRUGORE

Pas anulimit të tenderit për mirëmbajtje të rrugëve me vlerë 44 milionë euro, sipas të cilëve lejohej ngritja e vlerës së kontratës në 30%, rrjedhimisht bëhej 57 milionë euro, **është rishpallur tenderi me vlerë 35 milionë euro me të cilin janë kursyer 22 milionë euro.**

Testimi elektronik i kandidatëve për patentë shoferi është duke u implementuar në njësinë regjionale në Prishtinë, si fazë e parë. Kështu, Kosova i bashkëngjitet përvojave më të mira Evropiane në fushën e testeve të kandidateve për patentë shoferi. Në anën tjetër **është shfuqizuar vendimi i vitit 2019 për dhënie me Partneritet Publiko–Privat të Shërbimit të testimit të kandidatëve për shofer.**

IX.

ARSIMI DHE SHKENCA

SHOQËRI E DIJES

ARSIM CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS

Me përmirësimin e situatës me pandeminë, në muajin prill është marrë vendimi për rikthimin me pjesëmarrje fizike në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare deri në përfundim të këtij viti shkollor. Komunitat dhe shkollat kanë vendosur të punojnë sipas skenarëve A, B dhe C, në varësi të situatës epidemiologjike.

Gjatë kësaj kohë është organizuar

mësimi plotësues për 192,872 nxënës

që kanë pasur ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë COVID-19. Ai është zbatuar për nivelin e arsimit parauniversitar, në lëndët e gjuhës amtare, matematikës dhe shkencave të natyrës, në të gjitha komunitat.

Është organizuar mësimi alternativ i përshpejtuar për 441 nxënës në Komunën e Kamenicës,

dhe janë përgatitur udhëzues për mësimdhënësit që kanë punuar me nxënësit e përfshirë në këtë proces.

Në zbatim të vendimit të Qeverisë që gratë shtatzëna të lirohen nga procesi mësimor (me prezencë fizike), është arritur marrëveshja me Fakultetin e Edukimit që në vend të mësimdhënëseve shtatzëna, të angazhohen studentë me qëllim që të lehtësohet mbarëvajtja e procesit mësimor.

Në muajin maj u miratua Granti Specifik i arsimit parauniversitar **201,494,543 euro** në të cilin ndër të tjera parashihet:

- punësimi i 100 asistentëve shtesë për fëmijët me nevoja të veçanta, përveç 100 asistentëve të cilët tashmë janë të angazhuar
- pagesa e shpenzimeve për shujtën ditore për nxënësit e klasave 1-5,
- përkrahje për mësimdhënësit me gjendje të rëndë shëndetësore,
- pagesa për praktikën profesionale për nxënësit e arsimit dhe aftësimin profesional,
- rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm, etj.
- Pagat jubilarë

Me mbështetjen e Fondit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA)-së, janë lansuar Doracakët për Mësimdhënësit për Edukimin Gjithëpërfshirës Seksual, të cilët përfshijnë përmbajtje që mund të përdoren nga klasa 1-12. Lansimi i doracakëve të hartuar nga ekspertë të MASHTI-t, IKSHPK-së dhe mësimdhënësit u bë me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Higjienës Menstruale.

Në fushën ndërkombëtare është arritur marrëveshja për pjesëmarrjen e Kosovës në studimet ndërkombëtare TIMSS 2023 (Trends in International Mathematics and Science Study) dhe ICILS 2023 (International Computer and Information Literacy Study), të cilat ofrojnë informacion për performancën e nxënësve në fushën e matematikës dhe shkencave natyrore, si dhe për kompetencën digjitale të tyre. Po ashtu, Kosova do të jetë pjesë e studimit TALIS 2023 (Teaching and Learning International Survey) i cili është studimi më gjithëpërfshirës në botë për mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave.

Ndërsa me konkurs publik dhe në konsultim me partnerë ndërkombëtarë, janë emëruar katër anëtarë vendorë dhe tre ndërkombëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Kjo e bënë të mundur sigurimin e cilësisë, integritetit dhe transparencës së institucioneve të arsimit të lartë në harmoni me standardet ndërkombëtare.

HARMONIZIMI I ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL ME KËRKESAT E TREGUT TË PUNËS

Në përmbushje të njërës nga gjashtë zonat e domosdoshme për reformim dhe transformim që parashihet në Programin e Qeverisë, përkatësisht sistemit të bursave, që në 100-ditëshin e parë janë marrë vendime në dy drejtime shumë të rëndësishme.

Fillimisht me përkrahjen e Agjencisë Zhvillimore të Luksemburgut janë ndarë **90 bursa në drejtime deficitare të Arsimit dhe Aftësisit Profesional dhe me qëllim fuqizimin e vajzave.**

100 MIJË EURO PËR STUDENTË QË JANË PRANUAR NË UNIVERSITETE NDËRKOMBËTARE

Pastaj si mbështetje për studentë të dalluar, është shpallur thirrja publike prej 100 mijë euro për mbështetje financiare për studentët e pranuar në universitete të ndryshme në botë.

Gjithashtu, janë themeluar tri qendra të karrierës në tri qendrat e kompetencës: në Qendrën e Kompetencës Skenderaj, në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj dhe në

Qendrën e Kompetencës në Prizren, duke i kompletuar kështu të gjitha shkollat partnere me zyra të Qendrave të Karrierës, komponent ky shumë i rëndësishëm për informimin dhe orientimin e karrierës së nxënësve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës.





X.

**KULTURA,
RINIA DHE
SPORTI**

KULTURË

KAMPIONËSH

ARTI DHE KULTURA SI KONTRIBUES QENËSOR NË MIRËQENIEN SHOQËRORE

Në muajt e parë ka filluar procesi i reformimit administrativ i institucioneve kombëtare të kulturës. Tani, këtyre institucioneve do t'u mundësohet menaxhim autonom financiar. Kjo do të ndikojë në qëndrueshmërinë e tyre institucionale.

Gjatë kësaj periudhe kanë nisur edhe disa procese të dokumentimit kulturor. **Është themeluar grupi punues që do të hartojë programin shtetëror për të nderuar veprimtarinë e aktorit të madh Bekim Fehmiu. Veprimtaria e instrumentistit Shaqir Hoti është duke u dokumentuar, ndërsa Qeveria ka vendosur të marrë në përkujdesje gjithë fondin e instrumenteve dhe veprave të tij.**

Në mënyrë që veprimtaria artistike të konsolidohet, ka filluar faza e parë e përmirësimit të infrastrukturës fizike duke priorizuar ndërhyrjet urgjente rinovuese në institucionet kombëtare të kulturës.

Aktualisht po realizohen ndërhyrje në Teatrin Kombëtar, Baletin Kombëtar, Bibliotekën Kombëtare dhe Arkivin Shtetëror. Paralelisht është punuar në konceptimin e institucioneve të reja të kulturës, si institucioni i Operës së Kosovës. Ndërkohë, ka filluar edhe hartimi i konceptit për Teatrin e ri Kombëtar të Kosovës.

Për konsolidimin në aspektin legjislativ, ka filluar hartimi i Koncept Dokumentit për Ligjin e Kulturës.

TRASHËGIMIA KULTURORE

Gjendja fizike e aseteve të trashëgimisë kulturore për një kohë të gjatë ka qenë e injoruar duke rrezikuar kështu shkatërrimin e tyre. Ndërhyrjet emergjente në monumentet në rrezik do të nisin gjatë verës.

Do të mbrohen 200 asetet e rrezikuara të trashëgimisë kulturore

Përveç hartimit të listës prioritare për investime kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore, janë përzgjedhur **21 lokalitete të trashëgimisë kulturore të cilat do të restaurohen** në kuadër të projektit të bashkëpunimit me Bashkimin Evropian.

Një tjetër bashkëpunim me Bashkimin Evropian është edhe Revitalizimi i rrugës "Marin Barleti" në Prizren, Revitalizimi i Kinemasë "Lumbardhi" në Prizren dhe Revitalizimi i Qytetit të vjetër të Janjevës, për të cilat gjatë 100-ditëshit janë hartuar projektet zbatuese.

SPORTI ZHVILLUES I IMAZHIT SHTETËROR

Brenda 100 ditëve, janë lincencuar 40 federata sportive vendore. Për herë të parë, licencimi është bërë në afat kohor një vjeçar. Procesi i licencimit të rregullt do të realizohet në muajin e parë të vitit 2022 dhe janë nënshkruar memorandumet e bashkëpunimit me 40 federata sportive, me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Komitetin Paralimpik të Kosovës. Vlera totale e subvencionimit është mbi 2 milionë euro, ndërsa do të sigurohen fonde shtesë për përkrahjen e ngjarjeve të rëndësishme sportive me karakter ndërkombëtar, për organizimin e Kampionatit Botëror të Hendbollit Universitar që do të mbahet në Kosovë.



Kryeministri Albin Kurti dhe hendbollistet e përfaqësueses së Kosovës pas ndeshjes Kosovë - Luksemburg (33:27).

XI.

**POLITIKA E
JASHTME DHE
DIASPORA**

SUBJEKTIVITET

I FORTË

NDËRKOMBËTAR

REFORMA NË SHËRBIMIN E JASHTËM

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka zhvilluar 39 takime me përfaqësues diplomatik në Kosovë, 4 vizita jashtë vendit, 5 vizita të nivelit të lartë në Kosovë, 4 pjesëmarrje në forume/konferenca ndërkombëtare, 8 video-konferenca dhe takime virtuale.

Reforma e brendshme ka filluar me vendimet për kthimin e 13 ambasadorëve politikë

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës aktualisht është në proces të emërimit të ambasadorëve të rinj.

Si nevojë urgjente e funksionimit të MPJD-së, është përgatitur drafti i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm, përmes së cilit synohet reformimi i shërbimit të jashtëm. Projektligji, ndër të tjera përfshinë ndërtimin e një akademie të mirëfilltë diplomatike, priorizimin e diplomacisë ekonomike e kulturore dhe përzgjedhjen e diplomatëve në bazë të kriterëve.

Në lidhje me përmirësimin e Shërbimit të jashtëm, gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar:

- Marrëveshja e Mirëkuptimit me Akademinë e Shërbimit të Jashtëm të Bangladeshit
- Memorandumi i Mirëkuptimit me Ambasadën e Francës në Kosovë për kurset e gjuhës frënge dhe bursat nga Ambasada e Francës për zyrtarët kosovarë
- Protokollin e Marrëveshjes 2020-2021 me Ambasadën e Francës në Kosovë dhe Aleancën Franceze për kurset fillestare të gjuhës frënge
- Memorandumi i Bashkëpunimit me Institutin Diplomantik Bullgar (Akademia Diplomatiqe).

SHTETI LIGJOR DEMOKRATIK ME SYNIM INTEGRIMIN NË BE DHE NATO

Në kuadër të synimit tonë për integrim në BE dhe NATO është bërë:

- Akreditimi për herë të parë i Atasheut të mbrojtjes së Republikës së Kosovës në Gjermani
- Nënshkrimi i Memorandumit të Subvencionimit me Organizatën e Frankofonisë për vitin 2021 (PAF) në kuadër të projektit katërvjeçar IFN 2019-2022
- Bashkëorganizimi me Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe ambasadat e akredituara në Kosovë të Javëve të Frankofonisë
- Arritja e marrëveshjes Kosovë – Mbretëri e Bashkuar për Transportin Ndërkombëtar të Rrugëve
- Marrëveshja Kosovë–Hungari për Mbrojtjen dhe Promovimin e Ndërsjellë të Investimeve.

Bashkëpunimi me SHBA-të dhe Gardën Kombëtare të Iowa's është thelluar gjatë kësaj periudhe. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ambasadën e SHBA-së ka realizuar misionin e parë të zbakimit të përbashkët "co-deployment" të Forcës së Sigurisë së Kosovës në shtetin e Kuvajtit.

THELLIMI I BASHKËPUNIMIT ME VENDET ME INTERES STRATEGJIK DHE MARRËDHËNIEVE DYPALËSHE

Në 100 ditë, Kosovën e kanë vizituar zyrtarë të nivelit të lartë të shteteve partnere.

Vizitat e nivelit të lartë në Kosovë përfshijnë atë të ministrit të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, ministrit të Punëve të Jashtme të Kroacisë, ministrit të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë dhe vizita e përbashkët e përfaqësuesit Special të BE-së për Dialogun Kosovë-Serbi dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, dhe Zëvendësndihmës Sekretarit amerikan të Shtetit për Çështje të Evropës dhe Euroazisë.

Në prill, në vizitën e parë zyrtare pas formimit të Qeverisë, u prit ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Në prill po ashtu u prit në vizitë zyrtare edhe ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut ku u dakordua për një mbledhje të përbashkët të dy qeverive.

Në muajin maj, erdhi në vizitë zyrtare ministri i Punëve të Jashtme të Kroacisë. Në këtë takim u konfirmua se Qeveria e Kroacisë i dhuron Republikës së Kosovës **10,000 doza vaksina** në ballafaqimin e përbashkët me pandeminë.

Në muajin qershor, u mirëprit për vizitë zyrtare ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, me çka u shënua një **avancim shumë i rëndësishëm i raporteve dypalëshe**. Zyra për çështje tregtare dhe ekonomike e Kosovës në Athinë tanimë ka ngritur statusin e saj në Zyrë të Interesit që do të ketë qasje jo vetëm ekonomike por edhe politike.

Po ashtu **në muajin qershor**, u realizua edhe vizita e ministrit të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë, e cila u përcoll me **nënshkrimin e marrëveshjes dypalëshe për eliminimin e tatimit të dyfishtë** në të ardhura dhe parandalimin e evazionit dhe shmangies fiskale.

THELLIMI I BASHKËPUNIMIT ME SHQIPËRINË

Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Shqipërisë kanë marrë vendimet e para drejt jetësimit të mekanizmave për të mirën e përbashkët në fushat e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor. Në këtë drejtim është arritur:

- Marrëveshja për rikatëgorizimin e Pikës Kufitare Krushevë (DRAGASH) – Shishtavec (KUKËS) që kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin dhe lehtësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave jokomerciale dhe do të jetë një alternativë e pikës kufitare në Vërmicë

- **Marrëveshja për heqjen e leje-qëndrimeve të përkohshme me Shqipërinë, lehtësohen procedurat dhe zgjatë afatin e leje-qëndrimeve nga 1 në 5 vjet**
- Vendimi për jetësimin e plotë të marrëveshjes për lirin nga obligimi për pajisje me **Leje Punë afatshkurtër për shtetasit e Shqipërisë**. Shqipëria prej kohësh e ka zbatuar këtë marrëveshje për shtetasit e Kosovës
- Marrëveshja për trafikun lokal kufitar, sipas së cilës banorët e brezit kufitar do të pajisen me lejekalime të veçanta dhe do të kenë mundësinë të lëvizin lirshëm.

RRITJA E ROLIT TË MËRGATËS NË ZHVILLIMIN DHE PROMOVIMIN E VENDIT

Me qëllim të përfshirjes së mërgatës sonë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit brenda 100 ditëve është marrë vendimi për emetimin e letrave me vlerë, "Bono të Diasporës". Nëpërmjet tyre, **bashkatdhetarëve tanë do t'u mundësohet që kursimet dhe kapitalin e tyre t'i orientojnë në investime zhvillimore që do të krijojnë vende të reja të punës**.

Në të njëjtën kohë, edhe kësaj radhe Qeveria, përmes marrëveshjes me Byronë Kosovare të Sigurimeve dhe Bankën Qendrore të Kosovës ka marrë përsipër mbulimin e obligimeve të sigurimit të policës kufitare apo siç njihen si "Karton i Gjelbërt" për të gjithë bashkatdhetarët që hynë në Kosovë nga data 1 korrik deri në fund të këtij viti. **Në kuadër të kësaj marrëveshjeje**, nga Banka Qendrore e Kosovës po ashtu është marrë vendim që të **zbritet tarifa e policës së sigurimit kufitar për 35%**, gjë që nënkupton kursime të konsiderueshme.

RAPORTI ME SERBINË

Sa i përket Dialogut me Serbinë, për të cilin Qeveria angazhohet për njohjen e ndërsjellë mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, Kryeministri i Republikës së Kosovës ka paraqitur katër propozime:

1. Gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor e avancojnë CEFTA-n në SEFTA (South-East European Free Trade Agreement) sipas modelit të EFTA-EEA, pra marrëveshje çfarë Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Islanda kanë me BE-në.
2. Kosova dhe Serbia menjëherë nënshkruajnë një marrëveshje të përbashkët të paqes duke u zotuar se nuk do ta sulmojnë njëra-tjetrën. Kjo është e rëndësishme tani si asnjëherë më parë, një ditë pas Samitit të NATO-s në Bruksel dhe porosive unanime që u dhanë aty.
3. Pas njohjes së ndërsjellë midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në të dy vendet tona do të kemi reciprocitet bilateral, përfshirë çështjen e pakicave këtu. Pra, serbët në Kosovë mund të kenë Këshillin e tyre Nacional siç e kanë shqiptarët dhe boshnjakët në Serbi.
4. Për çështjen e të pagjeturve, të të zhdukurve me dhunë, duhet larguar nga pozita që ka dhe duhet marrë në pyetje kreun e delegacionit serb, z. Veljko Odaloviq, i cili në vitet 1997-1999, ishte "naçelnik i qarkut të Kosovës", dhe udhëhiqte me Kosovën e okupuar bashkë me z. Zoran Angjelkoviq.

Kurse, nëpërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, **Kosova për herë të parë i ka bërë kërkesa zyrtare Serbisë për kthimin e 1247 artefakteve të grabitura para më shumë se 20 vjetëve** e të cilat vazhdon t'i mbajë padrejtësisht dhe në kundërshtim me marrëveshjet paraprake, konventën e UNESCO-s mbi pasurinë kulturore dhe Planin e Ahtisaarit.



Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla në takim me zëvendëskryeminstren e Belgjikës dhe ministren e Punëve të Jashtme, Çështjeve Evropiane dhe Tregti të Jashtme, dhe Institucioneve Federale të Kulturës, Sophie Wilmès.

XII.

MBROJTJA

SHTET I SIGURT

DHE KONTRIBUES

I PAQES

ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR MBROJTJEN E SOVRANITETIT DHE INTEGRITETIT TERRITORIAL

Në mënyrë që Kosova të ketë një forcë të gatshme për mbrojtjen e vendit dhe të kontribuojë në paqen dhe sigurinë globale, janë ristrukturuar politikat e deritanishme të mbrojtjes krahas zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve. **Janë në proces të ndryshimit 27 rregullore dhe udhëzime administrative.**

Në bazë të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023, duke filluar nga viti 2021 për herë të parë buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes do jetë mbi 100 milionë euro.

Në mbledhjen e 17-të të qeverisë, u dha miratimi në parim për **blerjen e 4 dronëve amerikan** për ngritje të kapaciteteve për inteligjencë, vëzhgim dhe zbulim. **12.2 milionë euro për 100 ditë për blerje ushtarake.**

PËR HERË TË PARË, BUXHETI I MINISTRISË SË MBROJTJES MBI 100 MILIONË EURO

Nga ri-aranzhimet buxhetore me qëllim që të rritet mirëqenia e pjesëtarëve të FSK-së, **janë dedikuar 2.5 milionë euro për blerjen e autobusëve të rinj.**

Falë përkushtimit të Qeverisë për përparimin e raporteve të mira bilaterale dhe ndërkombëtare, dhe në funksion të zhvillimit të kapaciteteve për mbrojtje, **FSK ka pranuar autobлиндat ASV dhe pajisje për nevojat HAMZAT nga SHBA-të, pajisje ushtarake nga Mbretëria e Bashkuar dhe ka arritur kontingjenti i dyti i autobлиндave HMWV.**



Me qëllim që të rritet kapaciteti i përgjithshëm i FSK-së, 44 pjesëtarë janë duke u shkolluar në Akademitë Ushtarake të vendeve si SHBA, Gjermani, Mbretëri të Bashkuar, Turqi, Kroaci, Maqedoni e Veriut. Në kurset e zhvillimit të karrierës dhe ato specialistike vazhdojnë 50 pjesëtarë. Gjatë kësaj periudhe kanë përfunduar gjithsej 17 kurse trajnimi për 24 pjesëtarë të FSK-së.

Procesi i rekrutimit të 400 rekrutëve të rinj është realizuar dhe është hapur thirrja e re edhe për rekrutimin e 29 kadetëve tjerë të rinj. Për të siguruar një proces meritore dhe transparent, i gjithë procesi i rekrutimeve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës është monitoruar sipas marrëveshjes me Ambasadën Britanike.

PËRFSHIRJA E FSK-SË NË USHTRIMET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE

Kosova dhe Forcat e saj të Sigurisë për herë të parë kanë marrë pjesë në ushtrimin më të madh të organizuar në rajonin e Ballkanit, edhe në cilësinë e vendit pritës. **Kosova ishte në mesin e 27 vendeve pjesëmarrëse si dhe 16 vendeve pritëse të ushtrimit më të madh ndërkombëtar "DEFENDER-EUROPE 21".**

MISIONI I PARË HISTORIK PAQERUAJTËS NDËRKOMBËTAR

Forcat e Sigurisë së Kosovës kanë realizuar misionin e parë dhe historik të zbarkimit të përbashkët përkrah Ushtrisë Amerikane, në kuadër të Gardës Kombëtare të Iowa-s, në shtetin e Kuvajtit.

Përveç kësaj, pjesëtarët e FSK-së kanë marrë pjesë edhe në ushtrimet tjera jashtë vendit duke përfshirë këtu, UF "Combined Resolve XV" e organizuar nga USAREUR dhe realizuar në Gjermani, UF "Dynamic Front 21", në Gjermani dhe UF "LAUFER" në Kroaci.

FUQIZIMI I MBIKËQYRJES DEMOKRATIKE CIVILE DHE RRITJA E LLOGARIDHËNIES DHE TRANSPARENCËS

Për të rritur llogaridhënien dhe transparencën në politikat e mbrojtjes janë marrë disa vendime lidhur me rritjen e efikasitetit për përdorim të veturave zyrtare, uljen e shpenzimeve të reprezentacionit për lidhshirësinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së dhe janë ndaluar të gjitha aktivitetet jashtë planit të prokurimit. Në këtë kontekst, janë nënshkruar dy Memorandume të Bashkëpunimit me dy OJQ: "Instituti i Kosovës për Drejtësi" si dhe "INPO" dhe një Memorandum Bashkëpunimi me Ambasadën Britanike për asistencën teknike në fushën e prokurimit publik.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister